



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

Nr. 38 / prot.

Tiranë, më 26.03.2025

16

VENDIM

Nr. 1169, Datë 26.03.2025

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ
NDËRMARRJES ARLIS ADMINISTRIM SHPK NË TREGUN E OFRIMIT DHE
AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË
ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E
BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z. Denar BIBA	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Z. Durim KRAJA	Anëtar
Znj. Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.03.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.

Bazë ligjore: Neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 43, pika 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit D&L Administrim SHPK, Safe Security SHPK, Arlis Administrim SHPK;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi raportin të hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit D&L Administrim SHPK, Safe Security SHPK, Arlis Administrim SHPK;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Nisur nga disa ankesa të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës, mbi problematikat në zgjedhjen e ofrimit të shërbimit të internetit pranë disa komplekseve të pallateve në Tiranë, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë

28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, filloi monitorimin në tregun e ofrimit të shërbimit të internetit pranë disa komplekseve të pallateve në Tiranë.

2. Nga të dhënat e grumbulluara gjatë periudhës së monitorimit u krijua dyshimi i arsyeshëm se mund të ishim përpara abuzimit me pozitën dominuese nga ndërmarrjet e administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, në kuptim të nenit 9, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
3. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi me Vendimin nr. 1025, datë 18.10.2023 për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 13 tetor 2023.
4. Gjatë procedurës së hetimit paraprak dhe në përfundim të analizës së sjelljes së ndërmarrjeve të administrimit, u konfirmua edhe më tej se në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sjellja e ndërmarrjeve të administrimit mund të përbënte abuzim me pozitën dominuese kryesisht nëpërmjet: refuzimit të aksesit të ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë këtë shërbim; zbatimit të kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët dhe duke krijuar kushtet e favorshme për krijimin e pozitës dominuese të ndërmarrjeve të internetit brenda rezidencës që ata administrojnë.
5. Nisur nga analiza e bërë nga Sekretariati gjatë fazës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, u shpreh me vendimin nr. 1078, datë 10.05.2024 për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 10 maj 2024.
6. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar u vlerësua se, informacioni i administruar për ndërmarrjet D&L Administrim SHPK, Arlis Administrim SHPK dhe Safe Security Albania SHPK nuk ishte i mjaftueshëm për të përfunduar procedurat e hetimit të thelluar sipas afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024.
7. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit të thelluar me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve D&L Administrim SHPK, Arlis Administrim SHPK dhe Safe Security Albania SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës është i domosdoshëm për të siguruar një vendimarrje objektive.
8. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 3, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës me Vendimin nr. 1142 datë 27.12.2024, “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, vendosi që pika “II” dhe pika “III” në VKK nr. 1078/2024 të ndryshohet si vijon:

“II. Hetimi do të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 27 dhjetor 2024.

“III. Raporti i hetimit të thelluar për ndërmarrjet D&L Administrim SHPK, Arlis Administrim SHPK dhe Safe Security Albania SHPK duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 13.02.2025.”.

9. Në zbatim të këtij vendimi, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet e administrimit dhe nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e internetit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

10. Në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
11. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1142 datë 27.12.2024, “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, për ndërmarrjen e administrimit tregu përkatës i produktit përfshin, tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim.
12. Në rezidencat e banimit në Tiranë, ndërmarrjet e administrimit menaxhojnë pikën e aksesin në infrastrukturën e shërbimit të internetit. Si të tilla, këto ndërmarrje bëjnë lidhjet me ndërmarrjet e ofrimit të shërbimit të internetit dhe banorëve të cilët duan të përfitojnë këtë shërbim. Në të tilla kushte, ndërmarrjet e administrimit kanë ndikim në tregun e ofrimit të shërbimit të internetit, si dhënës të aksesit në infrastrukturë, në rezidencat ku ata operojnë. Pra, bazuar në këto fakte, tregu përkatës përfshin tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrja Arlis Administrim SHPK ka në administrim.
13. Ndërmarrjet që administrojnë rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës e ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm brenda rezidencës që ato administrojnë dhe përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre nuk kanë fuqi jashtë territorit të sipërfaqes së përbashkët që ata administrojnë.
14. Për sa më sipër, tregu përkatës gjeografik për ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, është territori i rezidencave të banimit që kjo ndërmarrje ka në administrim:

- [REDACTED]
- [REDACTED]

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

15. Në bazë të nenit 3, pika 5 të Ligjit nr. 9121/2003, “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.”

16. Sipas ligjit, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të Ligjit nr. 9121/2003.
17. Për të përcaktuar pjesët e tregut të ndërmarrjeve që administrojnë rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku të ishte përcaktuar xhiro dhe fitimi për secilën ndërmarrje administrimi që vepron në qarkun e Tiranës. Në informacionin e depozituar nga DPT, për një pjesë të madhe të ndërmarrjeve mungonin të dhënat përsa i përket xhiros dhe fitimit dhe për këtë arsye, është e pamundur që të llogariten pjesët e tregut për secilën ndërmarrjen administrimi në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit.
18. Ndërmarrjet që administrojnë rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës e ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm brenda rezidencës që ato administrojnë dhe përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre nuk kanë fuqi jashtë territorit të sipërfaqes së përbashkët të administruar prej tyre. Në bazë të nenit 19 të Ligjit nr. 10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, Kryesia, në emër dhe për llogari të Asamblesë, lidh kontratë me një shoqëri administrimi duke i dhënë kësaj të fundit të drejtën ekskluzive për administrimin e bashkëpronësisë.
19. Pjesë e objekteve në bashkëpronësi të ndërtesave konsiderohet dhe pika e aksesit në godinë sipas pikës 18 të VKM-së nr. 189, datë 30.03.2022 “Për përcaktimin e rregullave për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikës së aksesit në godinë”, e cila përcakton gjithashtu, në pikën 32 të saj, se administrimi i pikës së aksesit në godinë bëhet pikërisht nga administrator i godinës, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit dhe në përputhje me nenin 21, të Ligjit nr. 120/2016.
20. Për sa më sipër, ndërmarrja Arlis Administrim SHPK, duke qenë administratore e vetme në të gjitha rezidencat/godinat të cilat ajo administron, zotëron 100% të pjesëve të tregut përkatës dhe si rrjedhojë vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e aksesit të shërbimit të internetit brenda kufijve të rezidencave që ata administrojnë.
21. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve, fuqia kundërvepruese e konsumatorëve dhe blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja Arlis Administrim SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

22. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 27 dhjetor 2024, është realizuar në vijim të kërkesës për informacion drejtuar ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve që ofrojnë shërbimin e internetit.
23. Ndërmarrja Arlis Administrim SHPK, administron rezidenca në Tiranë,

24. Ndërmarrja Arlis Administrim SHPK bën me dije dhe gjatë hetimit paraprak dhe hetimit të thelluar, se në rezidencat të cilat administrojnë operojnë [redacted] operatorë që ofrojnë shërbimin e internetit, të cilët janë [redacted] por thekson se nuk ka kontrata bashkëpunimi, shërbimi dhe/ose kontrata të tjera, me këta operatorë.

25. Në lidhje me informacionin e kërkuar gjatë hetimit paraprak nga ndërmarrjet të cilat ofrojnë shërbimin e internetit në rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës, për rezidencat që administrojnë ndërmarrja Arlis Administrim SHPK janë shprehur si më poshtë:

- Ndërmarrja [redacted] sqaron se, përsa i përket rezidencës [redacted] nuk u lejohej të ofrojnë shërbim nga ndërmarrja që administrojnë kompleksin. Ndërmarrja nuk është prezente si ofruese shërbimi në rezidencën [redacted]
- Ndërmarrja [redacted] sqaron se në rezidencën [redacted] nuk janë lejuar të lidhin abonentë. Megjithatë, [redacted] jep shërbimin e internetit me fibra optike, por ky shërbim jepet vetëm për [redacted] si edhe për dy subjekte biznes. Ndërmarrja sqaron se nuk është lejuar të zhvillojë rrjetin në shkallët e këtij kompleksi për të lidhur abonentë. Gjithashtu, [redacted] bën me dije se nuk u lejohej të ofrojnë shërbim pikërisht nga ndërmarrja që administrojnë këtë kompleks. Ndërmarrja nuk është prezente si ofruese shërbimi në rezidencën [redacted]
- Ndërmarrja [redacted] deklaron se në rezidencën [redacted] ka [redacted] klientë. Ndërmarrja nuk është prezente si ofruese shërbimi në rezidencën [redacted] Këto shifra janë të vitit 2024, pra pasqyrojnë abonentët aktualë që ka ndërmarrja për shërbimin e internetit.
- Ndërmarrja [redacted] tregon se nuk ka klientë në rezidencën [redacted] po ashtu edhe në rezidencën [redacted] Gjithashtu, ndërmarrja pohon se nuk ka patur vështirësi në lidhjen e kontratave si edhe se nuk paguan tarifa për instalimin e shërbimeve tek zyrat e administrimit. Gjithashtu, kompania sqaron se nuk ka kontrata me zyrat e administrimit të pallateve apo komplekseve por vetëm me personat privatë ose kompanitë të cilët kërkojnë shërbimin e tyre.
- Ndërmarrja [redacted] sqaron se, përsa i përket rezidencës [redacted] nuk u lejohej të ofrojnë shërbim nga ndërmarrja që administrojnë kompleksin. Ndërmarrja nuk është prezente si ofruese shërbimi në rezidencën [redacted]
- Ndërmarrja [redacted] nuk ka asnjë klient në rezidencën [redacted] dhe në rezidencën [redacted] Në të dhënat e ndërmarrjes [redacted] është vënë re se në shumicën e rezidencave kjo ndërmarrje nuk ka prezencë. Megjithatë, ndërmarrja deklaron se nuk i është lejuar ofrimi i shërbimit në komplekset ku nuk ka asnjë abonent sepse u kërkohej një tarifë fikse mujore për çdo shkallë, u kërkohej lidhje interneti pa pagesë dhe u kërkohej tarifë instalimi. Ndërmarrja gjithashtu pretendon se, në rezidencat ku ata vetë nuk kanë abonentë, ndërmarrjet e administrimit kanë bërë marrëveshje me ndërmarrje të tjera të shërbimit të internetit dhe nuk lejojnë aksesin për shkak të këtyre marrëveshjeve. Ndërmarrja [redacted] bën me dije se nuk ka pranuar të ketë akses kundrejt pagesës, ndaj nuk paguan tarifë në pallatet ku japin shërbimin. Marrdhëniet me administratorët e pallatave i kanë bazuar në mirëkuptim dhe jo në hartimin e kontratave me shkrim.

- Ndërmarrja [REDACTED] tregon se nuk ofron shërbimin e internetit në kompleksin [REDACTED]
 - Ndërmarrja [REDACTED] shprehet se nuk u lejohet aksesit në rezidencën [REDACTED] nga ndërmarrja e administrimit, përse i përket shërbimit të internetit. Ndërmarrja shprehet se ndërmarrja e administrimit të këtij kompleksi ka kërkuar 35% të faturës mujore për çdo muaj për çdo klient si pagesë për lejin e aksesit në rezidencën [REDACTED]. Këtë pretendim ndërmarrja [REDACTED] e ngren edhe për [REDACTED] e cila administrohet nga e njëjta ndërmarrje administrimi. Për këtë shqetësim, ndërmarrja [REDACTED] i është drejtuar AKEP si edhe Bashkisë së Tiranës me një shkresë zyrtare. Në këtë ankesë, ndërmarrja [REDACTED] shpreh qartë problemin që ka hasur me pagesën, që ndërmarrja e administrimit kërkon për të lejuar aksesin e shërbimit të internetit nga kjo ndërmarrje. Gjithashtu, në këtë ankesë shprehet se ndërmarrja e administrimit nuk lejon banorët të zgjedhin firmën që ata dëshirojnë për të ofruar shërbimin e internetit, por jua përcaktojnë sipas marrëveshjeve që kanë me ndërmarrjet e tjera. Sipas [REDACTED] kjo është kthyer në një situatë shumë problematike, pasi vetë ndërmarrja nuk mund të kryejë lidhjet e fibrave optike për klientët të cilët kanë kërkuar shërbim nga kjo ndërmarrje specifikisht.
26. Në rezidencën [REDACTED] operatorët e shërbimit të internetit shprehen nuk lejohen nga ndërmarrja e administrimit Arlis Administrim SHPK të ofrojnë shërbimin, duke kufizuar numrin e operatorëve në rezidencë. Në këtë rezidencë shihet qartë prezencën e lartë e ndërmarrjes [REDACTED] e cila ka [REDACTED] abonentë nga [REDACTED] hyrje gjithsej të kompleksit, duke e bërë këtë operator të zotërojë [REDACTED] të hyrjeve në kompleks përse i përket shërbimit të internetit.
27. Në rezidencën [REDACTED] ndërmarrjet e shërbimit të internetit nuk kanë prezencë, si edhe ndërmarrja [REDACTED] ka shprehur se nuk është lejuar të ofrojë shërbim në këtë rezidencë, ashtu si edhe në rezidencën [REDACTED]
28. Në lidhje me informacionin e kërkuar gjatë hetimit të thelluar nga ndërmarrjet të cilat ofrojnë shërbimin e internetit në rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës, për rezidencat që administrojnë ndërmarrja Arlis Administrim SHPK janë shprehur si më poshtë:
- Ndërmarrja [REDACTED] përse i përket rezidencës [REDACTED] nuk është shprehur. Ndërmarrja nuk është prezente si ofruese shërbimi në rezidencën [REDACTED]
 - Ndërmarrja [REDACTED] sqaron se në rezidencën [REDACTED] nuk janë lejuar të lidhin abonentë. Ndërmarrja nuk është prezente si ofruese shërbimi në rezidencën [REDACTED]
 - Ndërmarrja [REDACTED] për rezidencën [REDACTED] nuk ka dhënë informacion, ndërsa për kompleksin [REDACTED] ka [REDACTED] abonentë.
 - Ndërmarrja [REDACTED] sqaron se nuk ofron shërbim për klientët fundorë dhe nuk ka patur kontakt me ndërmarrjet e administrimit.
 - Ndërmarrja [REDACTED] tregon se nuk ka klientë në rezidencën [REDACTED], po ashtu edhe në rezidencën [REDACTED]
 - Ndërmarrja [REDACTED] sqaron se, përse i përket rezidencës [REDACTED], dhe rezidencës [REDACTED] shprehet se për të dyja nuk ka akses.
 - Ndërmarrja [REDACTED] sqaron se ka shtrirje të aktivitetit vetëm në Bashkinë [REDACTED] dhe nuk disponon rrjet në teritorë të tjera.
 - Ndërmarrja [REDACTED] nuk ka asnjë klient në rezidencën [REDACTED] dhe në rezidencën [REDACTED]

- Ndërmarrja [REDACTED] tregon se nuk ofron shërbimin e internetit në rezidencën [REDACTED]
 - Ndërmarrja [REDACTED] për rezidencën [REDACTED] nuk është shprehur. Për rezidencën [REDACTED] e cila administrohet nga e njëjta shoqëri administrimi, nuk ka abonentë.
29. Në rezidencën [REDACTED] operatorët e shërbimit të internetit shprehen se nuk lejohen nga ndërmarrja Arlis Administrim SHPK të ofrojnë shërbimin, duke kufizuar numrin e operatorëve në rezidencë. Në këtë rezidencë shihet qartë prezenca e lartë e ndërmarrjes [REDACTED] e cila ka [REDACTED] abonentë nga [REDACTED] hyrje gjithsej të kompleksit, duke e bërë këtë operator të zotërojë [REDACTED] të hyrjeve në kompleks përsa i përket shërbimit të internetit.
30. Në rezidencën [REDACTED] ndërmarrjet e shërbimit të internetit nuk kanë prezencë përvec ndërmarrjes [REDACTED] me [REDACTED] abonentë nga [REDACTED] hyrje ose [REDACTED] të hyrjeve në këtë kompleks, si edhe ndërmarrja [REDACTED] ka shprehur se nuk është lejuar të ofrojë shërbim në këtë rezidencë, ashtu si edhe në rezidencën [REDACTED]
31. Në korrespondencën me ndërmarrjet e ofrimit të shërbimit të internetit përsa i përket provave faktike për ndalimin e ofrimit të këtij shërbimi nga ndërmarrja e administrimit të komplekseve dhe rezidencave më lart, u administruan përgjigjet në vijim:
- Ndërmarrja [REDACTED] shprehet se në rezidencën [REDACTED] megjithëse kanë rrjetin fibër dhe kasetat shpërndarëse në shkallën e kompleksit ku janë zyrat e tyre qendrore, janë lejuar të lidhin vetëm për [REDACTED] Në rezidencën [REDACTED] [REDACTED] shprehet se edhe pse ka rrjetin e tyre fibër të shtrirë përrreth kompleksit, nuk është lejuar të vendosë kasetat shpërndarëse në komplekset për të lidhur abonentë. Mungesa e aksesit në këto komplekse dhe rezidenca, teksa infrastruktura është e ndërtuar, sipas ndërmarrjes [REDACTED] përbën provë mbi moslejimin e aksesit të ofrimit të shërbimit të internetit.
 - Ndërmarrja [REDACTED] thotë se nuk është shprehur në asnjë rast që të ketë patur pengesa/ndalesa për akses në lidhje me ofrimin e shërbimit në rezidencat [REDACTED]
 - Ndërmarrja [REDACTED] shprehet se në rezidencën [REDACTED] nuk i lejohet ofrimi i shërbimit nga administrimi i kompleksit, kurse në kompleksin [REDACTED] nuk ka asnjë klient. Nuk disponon fakte/prova në mbështetje të pretendimit.
 - Ndërmarrja [REDACTED] shprehet se në rezidencat [REDACTED] nuk ka akses, dhe nuk ka prova konkrete pasi komunikimet me administratorët janë kryer verbalisht
 - Ndërmarrja [REDACTED] shprehet se në rezidencat [REDACTED] kanë [REDACTED] abonentë. Kjo ndërmarrje i liston këto komplekse si vende ku janë ndaluar por nuk ka prova të dokumentuara pasi ndalimi ka qenë vetëm verbal.
 - Ndërmarrja [REDACTED] shprehet se është përballur me pengimin e lejit të aksesit në godina vetëm për shkakun e mospagimit të tarifës së vendosur nga administratorët, por nuk disponon fakte ose prova për të mbështetur pretendimin e tyre pasi komunikimet janë kryer verbalisht. Për sa i përket rezidencave [REDACTED] [REDACTED] shprehet se nuk ka akses.
 - Ndërmarrja [REDACTED] shprehet se pranë rezidencave [REDACTED] nuk ofron shërbim. Me dijeninë e tyre në këto rezidenca operon ndërmarrja [REDACTED] [REDACTED] është prezent me infrastrukture fizike pranë këtyre komplekseve, por jo në brendësi të tyre. Skuadra e [REDACTED] që punon në terren nuk ka fakte/prova të shkruara që mund të mbështesin pretendimin për pengesën e aksesit. Sipas [REDACTED] kjo ndodh për shkak se pala tjetër është treguar shumë i kujdesshëm për të mos lënë evidenca të tilla.

32. Nga të dhënat e administruara nga ndërmarrja Arlis Administrim SHPK si edhe nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e internetit në rezidencën [REDACTED] vihet re se ka problematika në ofrimin e këtij shërbimi.
33. Në rezidencën [REDACTED], operatorët e shërbimit të internetit shprehen nuk lejohen nga ndërmarrja Arlis Administrim SHPK të ofrojnë shërbimin, por se nuk kanë prova dhe fakte konkrete për të mbështetur këtë pretendim.
34. Në rezidencën [REDACTED] ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e internetit shprehen se nuk lejohen nga ndërmarrja Arlis Administrim SHPK të ofrojnë shërbimin, por se nuk kanë prova dhe fakte konkrete për të mbështetur këtë pretendim.
35. Si konkluzion, sjellja e ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, nuk përbën abuzim me pozitën dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.
- II. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA

Zv/Kryetar

Rezana KONOMI

Anëtar

Durim KRAJA

Anëtar

Fatjola DELIJA

Anëtar

Denar BIBA

Kryetar

